



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:037019
Datë: 03.01.2024
Numri i dokumentit: 05147619

Parashtruesi i ankesës:

N G, fshati G, Lipjan

Kundër

Pala kundërshtare:

Ndërmarrja Shoqërore “Seperacioni i Gurëve-Gadime”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) gjyqtarja Manushe Karaçi më 29 dhjetor 2023, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- I. Ankesa e parashtruesit hedhet poshtë si e papranueshme.**
- II. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 29 korrik 2014, paditësi ka dorëzuar padinë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër vendimit PRN051-0157 të Autoritetit të Likuidimit të nxjerrë më datën 9 korrik 2014, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara në shumë prej 600 euro.

Parashtruesi kërkesën për rishikim të vendimit e ka dorëzuar përshkak të :

- Shkeljeve të dispozitave materiale,
- Shkeljeve të dispozitave procedurale,

- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Parashtruesi ka theksuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit e kishte refuzuar kërkesën e paditësit me arsyetimin se kërkesa është parashkuar duke iu referuar Nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 53 të vitit 1976) i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24.

Kësisoj, parashtruesi ka kërkuar nga gjykata që të bëjë rishikimin e vendimit PRN051-0157 të Autoritetit të Likuidimit të nxjerrë më datën 9 korrik 2014, ashtu që vendimi i lartcekur të priset dhe paditësit t'i njihet e drejta në kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 600 euro.

Më 1 dhjetor 2023, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka lëshuar një urdhër, me të cilin ka kërkuar nga parashtruesi që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimin të këtij urdhri, të dorëzojë në gjykatë Kopjen e vendimit të kundërshtuar si dhe prova dhe dëshmi relevante në mbështetje të pretendimeve ankimore.

Në bazë të fletëkthesës gjykata vëren se parashtruesi e ka pranuar urdhrin e gjykatës më 11 dhjetor 2023, por gjer më sot nuk e ka dorëzuar ankesën e precizuar si dhe dokumentacionin e kërkuar.

Më 22 dhjetor 2023, AKP-ja dorëzoi mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit të dorëzuar më 29 korrik 2014 kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN051-0157 të nxjerrë më datën 9 korrik 2014

AKP-ja përmes mbrojtjes së saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me PRN051-0157 të nxjerrë më datën 9 korrik 2014

Arsyetimi Ligjor:

Ankesa e parashtruesit hedhet poshtë si e papranueshme.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në kuptim të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktvendim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtruesat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese).

Pika 3 e këtij neni parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Dhoma e Posaçme, pasi që shqyrtoi ankesën e dorëzuar dhe shkresat e tjera të lëndës konstatoi se ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme. Neni 36 paragrafi 2 pika 2.5 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se *”kërkesa/ ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji”*.

Neni 35 paragrafi 2 pika 2.4 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se ankesa duhet të përmbajë: *“lëndën dhe të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën, bazën për juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme në lidhje me kërkesën apo ankesën, argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet kërkesa apo ankesa dhe një listë provash që parashtruesi synon t'i paraqes”*.

Parashtruesi ka kërkuar nga gjykata që të bëjë rishikimin e vendimit PRN051-0157 të Autoritetit të Likuidimit të nxjerrë më datën 9 korrik 2014, ashtu që vendimi i lartcekur të priset dhe paditësit t'i njihet e drejta në kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 600 euro. Megjithatë parashtruesi nuk ka dorëzuar ankesën e precizuar kundër vendimit të kundërshtuar në emër të tij.

Parashtruesit gjykata i bën me dije se sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Për më tepër edhe në bazë të nenit 31, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili përcakton se: *‘Palët, në parashtrësit e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës’*.

Me nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parashihet që: *‘në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore’*.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në pajtim me nenin 33 paragrafi 1 dhe nenin 36 paragrafi 2 pika 2.3 e Ligjit për Dhomën e Posaçme vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Duke u bazuar në Nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

**GJYQTARJA,
Manushe Karaçi**